

William R. Hite, Jr., Ed.D.
Superintendent

21 Janar, 2021

Të dashur Familjarë të Drejtorise Arsimore te Filadelfias:

Regjistrimi për kopshtin për vitin shkollor 2021-2022 është tani i hapur. Nëse keni djalë apo vajzë që do të jetë pesë vjeç më ose para 1 Shtatorit ju lutem regjistrohuni deri ne 28 Maj për t'i dhënë atyre një mundësi për të pasur sukses në moshën 5 - vjeçare.

Ekzistojnë katër mënyra për t'u regjistruar: në

- internet duke përdorur këtë [portal të regjistrimit në internet](#).
- Personalisht në “Education Center” , vetëm me takim. Telefononi në 215-400-4290 për të caktuar orarin e takimit
- Përmes telefonit duke telefonuar në shkollën e lagjes tuaj. Gjeni numrin e telefonit të shkollës tuaj [këtu](#).
- Përmes vendosjes / hedhjes së dokumentave në kutinë që ndodhet në sallën e “Education Center” . Gjeni më shumë udhëzime [këtu](#).

Regjistrimi deri më 28 Maj është i rëndësishëm sepse u jep familjeve dhe fëmijëve kohë për t'u takuar me personelin e shkollës dhe për t'u njohur me një shkollë, e cila ndihmon që tranzicioni i kopshtit të jetë i qetë. Drejtoria do të zhvillojë “ Ditën e Kopshtit” në 2 Mars dhe “ Javën e Kopshtit “ më 3 Maj. Këto mund të jetë virtuale ose personale, në varësi të protokolleve të shëndetit dhe sigurisë. Ju lutemi vazhdoni të vizitoni philasd.org/thriveatfive për azhurnime.

Drejtoria gjithashtu ka një program për kopshtin parashkollor, Pre / K , me rreth 200 vende në të gjithë qytetin për t'i shërbyer nxënësve tanë më të rinj. Ky program ofron një kurrikulë me cilësi të lartë, mbështetje për nevoja të veçanta dhe mundësi për pjesëmarrje të prindërve. [Klikoni këtu për të mësuar më shumë rreth kopshtit parashkollor.](#)

Pjesëmarrja në programin parashkollor i vendos fëmijët në një rrugë drejt suksesit në shkollë dhe në jetë. Gjatë këtyre viteve, ata mësojnë të luajnë mirë me të tjerët, të bëjnë miq, të krijojnë besim dhe të fillojnë të mësojnë të lexojnë dhe të shkruajnë - të gjitha këto aftësi shumë të rëndësishme që i ndihmojnë fëmijët të kenë suksese .

Ju lutem mos vononi. Regjistrojeni fëmijën tuaj në kopsht sot!

Sinqerisht,



William R. Hite Jr., Ed.D.
Superintendent
Drejtoria Arsimore e Filadelfias